


“DARDANIA” College



**Kolegja Dardania
(Qendra për hulumtime shkencore)**

**Plani Strategjik për Hulumtime Shkencore dhe Projekte të Stafit Akademik
(2021-2024)**

17.09.2021, PRISHTINË

PËRMBAJTJA:

- I. Misioni
- II. Përbledhje Ekzekutive
- III. Përbledhje e objektivave dhe iniciativave strategjike
 - 3.1. Plani tre vjeçar
 - 3.2. Fushat strategjike, objektivat e iniciativave strategjike
- IV. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

1. Misioni

Kolegji DARDANIA është përgjegjës që përmes mësimdhënies dhe hulumtimit të zhvillojë staf të aftë për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe kreativ në shërbim të komunitetit, të krijojë staf profesional dhe kompetent për të përmbushur kërkosat në kontekstin e zhvillimit ekonomik dhe politik si dhe të jetës socio-kulturore në Kosovë.

Kolegji DARDANIA inkurajon studimet ndërdisiplinore dhe multidisiplinare, të cilat sjellin pasurimin e njouhurive të studentëve dhe aftësinë e tyre për të mësuar gjithë jetës.

Kolegji Dardania synon të kontribuojë në avancimin e Arsimit të Lartë në Kosovë duke ofruar mësimdhënie dhe kërkime cilësore. Komuniteti akademik dhe studentor i Kolegit DARDANIA është i përkushtuar që të bëjë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin social dhe ekonomik të shoqërisë së Kosovës.

Janë tre pikë kryesore mbi të cilat Kolegji DARDANIA projekton vizionin e tij: liria akademike, mbështetja e studentëve me bursa dhe inovacioni.

Kolegji Dardania është krijuar duke u bazuar në idenë se diversiteti pasuron vlerat tona akademike dhe rrit interesin e studentëve për të mësuar. Prandaj, Kolegji DARDANIA është i përkushtuar për të ofruar mundësi të barabarta për stafin e tij akademik dhe studentët. Një nga pikat e forta të Kolegit DARDANIA janë programet e tij unike të studimit me kurrikulë multidisiplinore të ofruara për studentët e tij, e cila u mundëson të gjithë pjesëmarrësve në vizionin e Kolegit DARDANIA të jenë pjesë e komunitetit tonë.

2. Përbledhje ekzekutive

Kolegji Dardania do të vazhdojë të krijojë mekanizmat institucional dhe të ndërtojë kapacitetet për hulumtime shkencore të cilat janë në funksion të zhvillimit shkencor të mësimdhënësve e të studentëve, por edhe në shërbim të zhvillimit shoqëror e ekonomik të vendit. Kjo do të arrihet duke shtuar investimet në shkencë dhe duke u fokusuar më shumë në kërkime të aplikuar që ndihmojnë realizimin e misionit të tretë dhe i kontribuojnë zhvillimit në vend. Kërkimi shkencor do të jetë edhe një urë lidhëse në mes të personelit të Kolegit Dardania dhe të kolegëve në vend dhe në botë nëpërmjet të konferencave dhe

projekteve të përbashkëta hulumtuese. Për vite me radhë Kolegji Dardania ka publikuar revisten shkencore dhe mban koferenca kohe pas kohe.

Andaj, me implementimin e këtij dokumenti, Kolegji Dardania ka për synim që të përbushë qëllimin e vet duke:

- Aplikuar standartet, rregulloret dhe transparencën në përzgjedhjen e stafit akademik;
- Ofruar zhvillim profesional të stafit akademik në metodat e mësimdhënies në dobi të studentëve;
- Siguruar komunikimin e vazhdueshëm student-mësimdhënës për arritjen e rezultateve më të mira të mësimnxënies;
- Nxitur kërkimin shkencor te mësimdhënësit dhe studentët;
- Orientuar studentët që të jenë pjesë e forumeve ndërkombëtare në rritjen e kapaciteteve, për ndryshimet apo përmirësimet konform kërkesave të kohës.
- Shërbimet e informacionit dhe ato administrative janë të domosdoshme që të garantojnë mbarëvajtje të punëve dhe proceseve brenda Kolegit Dardania.

Emëruesi i përbashkët i tërë kësaj pune është cilësia e programeve për sigurim të akreditimit të vazhdueshëm me synimin për të:

- Fuqizuar një sistem të rendshëm të sigurimit të cilësisë;
- Analizuar dhe mbikëqyrur vazhdimisht mbarëvajtjen e programeve;
- Ofruar programe të reja apo rishikimin e programeve aktuale, varësisht prej nevojave të tregut të punës;
- Mbikëqyrur dhe vlerësuar angazhimin e stafit akademik;
- Aplikuar te nxënët aktiv me qëllim të zhvillimit të mendimit kritik të studentëve dhe shprehjes së lirë.

II. Përbledhje e objektivave dhe inciativave strategjike

Në përputhje me vizionin dhe mision e vet, Kolegji Dardania ka identifikuar një numër të objektivave strategjikë, me synimin përfundimtar që të avancojë pozitën konkurruese përmes ofrimit të shërbimeve cilësore, pa dallim, për nevojat e popullsisë së Kosovës dhe më gjërë. Për këtë qellim, ne kemi identifikuar priorititetet në përputhje me kapacitetet dhe resurset

njerëzore/humane, ashtu që Kolegji të zhvillohet dhe udhëhiqet drejt përmbushjes së objektivave strategjikë. Prioritetet janë si në vijim:

Rritja e cilësisë në arsim dhe kërkim shkencor/artistik – Krijimi i një modeli të ri për arsimin parauniversitar për të përgatitur më mirë studentët e Kolegit Dardania për një botë në ndryshim. *Nxitja e hulumtimeve kërkimore shkencore/artistike* – Të mbështesim misionin tonë kërkimor duke rritur financimin institucional dhe shpenzimet kërkimore; të ofrojë investime me shënjestër kërkimin më të avancuar dhe punën krijuese;

Zhvillimi dhe qëndrueshmëria e programeve – Duke u bazuar në kërkkesat e tregut dhe konkurrencës globale, kjo do të kërkojë ndjekjen e trendeve në zhvillimin e vendeve të punës dhe nevojave si dhe të një procesi për të matur qëndrueshmërinë e programeve aktuale dhe programet e ardhshme në Kolegj.

3. Plani tre vjeçar

Kolegji DARDANIA ka përpiluar dhe zbatuar planin strategjik tre vjeçar për Zhvillimin e Kërkimeve, si dokument i funksionimit të vazhdueshëm të Këshillit Kërkimor në kuadër të programeve të studimit të ofruara nga institucioni ynë. Këshilli i Kërkimit bazohet në tre qendrat kërkimore, me hapësira adekuate, ku përfshihen salla kërkimore si dhe salla e videokonferencave, e cila shërben më së shumti për mbledhjen e të dhënave (intervistimi i hulumtimeve, ekspertëve ndërkombëtarë përfshirë specifike të hulumtimit).

Ky plan zhvillimor tre vjeçar është gjithashtu rezultat i punës kërkimore të njëpasnjëshme të kryer nga stafi ynë akademik së bashku me udhëheqjen e Kolegit DARDANIA, njësitë e studimit dhe palët e jashtme të interesuara. Këshilli Kërkimor përbëhet nga personel akademik me nivel të lartë profesionalizmi në fushën e tyre të studimeve. Informacione të mëtejshme në lidhje me zbatimin e planit strategjik në nivel institucional mund të gjeni në Planin Strategjik (2022-2027) të Kolegit DARDANIA.

Plani Zhvillimor për Hulumtim përfaqëson të gjithë vizionin e Kolegjit DARDANIA dhe objektivat e tij lidhur me avantazhet konkurruese në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar; inkurajimin e stafit akademik për përpilimin e projekteve hulumtuese, shtimin e hulumtime individuale e grupore, aftësimin vazhdueshëm të stafit në punën kerkimore si dhe inkurajimin e studentëve për pjesëmarrje si bashkëpunëtorë të rinjë (asistentë) në projektet hulumtuese, sepse ata do të janë liderë të së nesërmes.

Angazhimet e Kolegjit DARDANIA

Përmirësimi i cilësisë së aktiviteteve hulumtuese

Forcimi i kapaciteteve dhe përmirësimi i hapësirave të punës hulumtuese
Kolegji DARDANIA posidon një infrastrukturë moderne dhe komode që u mundëson studiuesve të kenë hapësira të përshtatshme pune, së bashku me mbështetjen e vazhdueshme financiare përpajisje të reja, dhe trajnime për të inkurajuar stafin dhe studentët ekzistues që të angazhohen në projekte të mëtejshme kërkimore.

Për një të ardhme më të mirë

Këshilli i Hulumtimece shkencore është i përkushtuar që të nxise studiuesit e Kolegjit DARDANIA që të janë kontribues në përmirësimin e kushteve ekzistuese të sektorit social dhe ekonomik në Kosovë. Kolegji DARDANIA ka përmirësuar vazhdimeshit infrastrukturën e tij dhe do ta bëjë këtë edhe në të ardhmen me synimin përzgjerimin e aktiviteteve hulumtuese në kontekst më të gjerë të shkencave.

Hulumtimet udhëhiqen nga vullneti për të kontribuar në mirëqenien e shoqërisë, dhe Kolegji DARDANIA u ofron atyre mundësinë që në mënyrë të pavarur të kryejnë hulumtime në fushën e tyre të ekspertizës, duke trajtuar çështje të rëndësishme me të cilat po merret shoqëria kosovare.

Objektivat e hulumtimit:

- Shtimi i kapacitetit të resurseve njerëzore të afsta përpilimin e projekteve shkencore;
- Krijimi i kushteve për punë kerkimore (objekt, bibliotekë, IT dhe pajisje moderne);
- Ofrimi i mundësive dhe inkurajimi i studiuesve të rinj;
- Zhvillimi i bashkëpunimit me aktorët e jashtëm (Organizatat e Shoqërisë Civile, sektori publik dhe privat dhe sipërmarrjet);

- Zhvillimi i mëtejshëm dhe investimi në projekte inovative.

I. Fushat strategjike, objektivat e iniciativave strategjike

Kolegji Dardania do të vazhdojë të zhvilloj kritere për stimulimin e personelit të përfshirë në punë kërkimoro-shkencore. Këto kritere duhet të përfshijnë: numrin dhe vlerën e projekteve shkencore të realizuara, numrin e publikimeve shkencore të publikuara në revistat shkencore të indeksuara në platformën Web of Science (WoS) dhe në platformën Scopus, lehtësime të veçanta kontraktuale për pjesëmarrje në programet kërkimore e shkencore (pasdoktorale, hulumtime të shkurtra në qendrat e përsosmërisë në të gjithë botën, etj.). Mbështetja do të synoj përfshirjen e hulumtuesve në fushat prioritare dhe interdisiplinare, në fushat ku ka mungesë të hulumtuesve në Kolegin Dardania dhe përkrahjen e të rinjve që janë të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve hulumtuese në Kolegin Dardania.

Kolegji Dardania do të ofroj mbështetje për mobilitet afatshkurtër të hulumtuesve nga Kolegi në institucionet e vendeve të zhvilluara. Për të realizuar këtë aktivitet, Kolegji do të zhvilloj procedura që rrisin cilësinë dhe konkurrencën e veprimtarisë kërkimoro-shkencore si: zhvillimi i kritereve për përzgjedhjen e përfituesve, informimi dhe shpallja publike me kohë lidhur me këtë mundësi, ndihmë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e qëndrimit afatshkurtër të personelit akademik jashtë vendit. Aktiviteti i tillë duhet të çoj në botime ose në krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm midis institucionit vendor dhe institucioneve te jashtme.

Kolegji Dardania do të favorizoj projektet me qasje interdisiplinare dhe me prioritet të cilat ngërthejnë në vete aktivitete kërkimore e shkencore për përbushjen e nevojave të vendit. Me prioritet të veçantë do të jenë projektet kërkimore e shkencore të cilat realizohen përmes bashkëpunimit ndërkombëtar. Me qëllim të fuqizimit të punës ekipore dhe shfrytëzimit racional të personelit akademik dhe infrastrukturës ekzistuese, Kolegji Dardania do të nxisë komunikimin (veprimtarinë) kërkimoro- shkencore i cili promovon bashkëpunim brenda dhe në mes të njësive akademike të Kolegit Dardania. Për këtë çështje, Kolegji Dardania së bashku me menaxhmentin e njësive akademike do të sigurojnë marrëveshje kontraktuale për personelin e angazhuar në projekte të tillë.

Kolegji Dardania do zhvilloj kritere për stimulimin e personelit të përfshirë në punë kërkimoroshkencore. Këto kritere duhet të përfshijnë: numrin dhe vlerën e projekteve shkencore të realizuara, numrin e publikimeve shkencore të publikuara në revistat shkencore të indeksuara në platformën Web of Science (WoS) dhe në platformën Scopus, lehtësime të veçanta kontraktuale për pjesëmarrje në programet kërkimore e shkencore (pasdoktorale, hulumtime të shkurtra në qendrat e përsosmërisë në të gjithë botën, etj.). Mbështetja do të synoj përfshirjen e hulumtuesve në fushat prioritare dhe interdisiplinare, në fushat ku ka mungesë të hulumtuesve në Kolegin Dardania dhe përkrahjen e të rinxve që janë të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve hulumtuese në Kolegin Dardania.

Në vitet në vijim do të lidhen partneritete strategjike me institucionet me reputacion ndërkombëtar që kanë interes për bashkëpunim me Kolegin Dardania. Kolegji Dardania do të vazhdoj me zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe me lidhjen e marrëveshjeve të reja, i vetëdijshëm se çdo projekt i përbashkët kërkimor është në funksion të avancimit të veprimtarisë kërkimoroshkencore në vend. Manifestimi më i dukshëm i partneriteteve të tilla është aplikimi i përbashkët përfundim kërkimore dhe realizimi i përbashkët i projekteve kërkimore. Mënyra më e mirë për t'i identifikuar këto institucionet është realizimi i marrëveshjeve ekzistuese përfundim kërkimore dhe realizimi i përbashkët i projekteve kërkimore. Mënyra më e mirë përfundim kërkimore është realizimi i marrëveshjeve ekzistuese përfundim kërkimore.

Kjo zyre do të identifikoj një grup prej disa anëtarësh të personelit akademik të Kolegit Dardania që kanë përvojë në hartimin ose menaxhimin e projekteve ndërkombëtare të karakterit akademik dhe janë të gatshëm që përvojën e tyre ta vënë në dispozicion të avancimit të veprimtarisë kërkimoro-shkencore në Kolegji. Ky grup bërthamë do të trajnohet përfundim kërkimoro-shkencore. Përfundim kërkimore është mëtutjeshëm të anëtarëve të grupit bërthamë do të shfrytëzohen projektet ekzistuese të donatorëve. Anëtarët e grupit bërthamë do të janë në dispozicion përfundim kërkimore është ofruar asistencë teknike përfundim kërkimore dhe realizimi i përbashkët i projekteve kërkimore. Ata do të kontraktohen nga Kolegji Dardania përfundim kërkimore për çdo rast të veçantë të ofrimit të shërbimeve të tilla dhe do të janë përgjegjës përfundim kërkimore.

kërkesat administrative që përejellin çdo aplikim. Si përbledhje, ky dokumente potencon edhe njehere objektivat e tij:

(1) Ngritja e resurseve humane për mësimdhënia, dhe hulumtime, që përfshinë:

- a) Aftësimi i vazhdueshëm i stafit akademik për mësimdhënie të përparuar, për hulumtime dhe përpilim të projekteve të reja;
- b) Sigurimi i bashkëpunëtorëve partnerë në hulumtime nga universitetet partnere;
- c) Sigurimi i zhvillimit profesional dhe mbështetjes për hulumtime, analiza statistikore, shkrimit të arstikujve për revista, ditarë finansiarë dhe kosto të publikimit sipas nevojës;
- d) Aftësimi i kuadrit për hartimin e projekteve që sigurojnë të hyra për Kolegin dhe për bartëist e projektit;
- e) Avancimi i praktikës për angazhimin e studentëve si asistent ndihmës për realizimin e projekteve hulumtuese;
- f) Ngritje e produktivitetit shkencor-hulumtues.

(2) Puna kërkimore shkencore/artistike që përfshinë:

- a) Rritja e rezultateve kërkimore –shkencore/artistike të stafit akademik në revista konkurruese të pranuara ndërkombëtarisht në fushën e tyre;
- b) Sigurimi i zhvillimit profesional dhe mbështetjes në metodologjinë e hulumtimit, analiza statistikore, shkrimit për revista, ditarë dhe koston e publikimit sipas nevojës;
- c) Rritja e mundësive për realizimin e punëve dhe shërbimeve, që janë burim i të hyrave të Kolegjit Dardania;
- d) Krijimi i kushteve për aktivitete shkencore në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare.

II. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Monitorimi dhe vlerësimi janë faktorë themelorë të zbatimit të një strategjie dhe synojnë matjen e progresit të arritur. Këshilli Drejtues i Kolegjit Dardania emëron një komision për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të kësaj strategjie, sipas dinamikës së paraparë për Planin e Veprimit. Komisioni për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të strategjisë, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat relevante të Kolegjit Dardania, do të monitorojë

rregullisht zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie dhe në etapa të caktuara të raportojë. Këshilli Drejtues i Kolegjit Dardania do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e kësaj strategjie.

Të dhënrat që njësitë akademike dhe zyrat përkatëse do të dorëzojnë në komision për monitorim dhe vlerësim duhet të përfshijnë: aktivitetet e realizuara dhe progresin, efektet, ndikimet, vështirësitë, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet.

Monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm i kësaj strategjie përmes Planit të Veprimit iu siguron zbatuesve të saj një pasqyrë, e cila ua mundëson të veprojnë me kohë dhe në përputhje me nevojat dhe sfidat, me të cilat përballet aktualisht sektori i arsimit të lartë, por edhe në të ardhmen. Plani i Veprimit i kësaj strategjie është ndërtuar në një strukturë tabelare, progresi i të cilët do të monitorohet rregullisht në takimet e rregullta të udhëhequra nga Komisioni për Monitorim dhe Vlerësim. Në tabelen në vijim janë të permbladhura disa objektiva dhe indikatorë.

Tabela 1. Puna kërkimore shkencore/artistike

Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat – aktivitetet	Indikatorët	Afatet kohore	Stafi / përgjegjësitë	Burimet/ kosto në euro
Të rriten rezultatet e kërkimit shkencor/aristik	Promovimi i kërkimeve shkencore/artistike për stafin akademik në revista të mirëfillta shkencore dhe platformë kredibile.	- Raportimi në baza vjetore për rezultatet e arritura dhe masat obligative të ndërmarra - Krijimi i grupeve kërkimore shkencore/artistike në kuadër të NjA-ve.	-Numri i punimeve të publikuara; -Numri i konferencave -Numri i grupeve kërkimore shkencore/artistike të themeluara	Prill, 2021-vazhdon	Menaxhmenti/NjA/ZKPS	10% e buxhetit vjetor të UD-së
	Mbështetja e përvetësimit të granteve kërkimore/shkencore nga agjencitë kombëtare të financimit dhe institucionet private apo publike.	-Krijimi i dispozitave ligjore të nevojshme; -Përditësimi i vazhdueshëm i informatave në ballinën e ueb faqes së KD-se për mundësitë e financimit kërkimore/shkencore/artistik; -Trajnim i stafit për aplikime në grante kërkimore	Ofrimi i dispozitave ligjore të nevojshme; -Ofrimi i informatave të përditësuara vazhdimesh në ballinën e ueb faqes së KD-së për mundësitë e financimit; -Rritja e aplikimit për grante kërkimore shkencore nga ana e stafit akademik	Prill, 2021-vazhdon	Menaxhmenti (ZMJ/ZZ HA)NJ A/ZKPS	Zero kosto
Përmirësimi dhe rritja e rezultateve hulumtuese në UD.	Inkurajimi i përfshirjes së kapaciteteve të diasporës në kërkime shkencore/ arte dhe aktivitete zhvilluese artistike si dhe	-Vendosja e kontakteve dhe përkrahja e hulumtuesve nga diaspora. - Zhvillimi i kontakteve me hulumtues tjerë ndërkombëtare me	Identifikimi i kontakteve dhe hulumtuesve mbështetës nga diaspora; - Krijimi i bazës së të dhënave të kontakteve			Shih: Plani i zhvillimi strategjike te Kolegje Dardania

	përmirësimi i bashkëpunimeve tjera ndërkombe	qëllim të ngritjes së bashkëpunimeve kërkimore/shkencore -Përcaktimi i detyrimeve kontraktuale për veprimitari kërkimore shkencore/artistike për stafin akademik.	të hulumtuesve nga diaspora; - Promovimi i pozitës për profesorët “adjunct” për ligjërim dhe hulumtime nëpër njësitet akademike që kanë në dispozicion kapacitete. -Krijimi i bazës ligjore dhe rregulloreve për angazhimin e stafit të UD-së duke u bazuar në praktikat më të mira evropiane.			
	Ngritja e integritetit akademik gjatë punës kërkimore/shkencore/ artistike.	-Adresimi i rasteve të plagjiarizmit te stafi akademik dhe studentët.	- Aplikimi i programeve softuerike dhe implementimi.	Qershori 2021- dhe në vazhdim	Menaxhmenti/ Senati/ Këshilli i Etikës/ NJA	Zero kosto
Inovacioni gjatë punës kërkimore/s h kencore/arti stike.	Përkrahja e inovacioneve dhe mbrojtja e pronës intelektuale të UD-së.	-Hartimi i bazës ligjore për inovacionet; -Harmonizimi i Ligjit për Pronësinë Intelektuale në rregulloret e UD-së.	-Rregullorja për inovacionet në UD; -Futja e deklaratës etike për pronësinë intelektuale dhe inovacionin; -Hartimi i rregullores për pronësinë intelektuale të UD-së.	Dhjetori 2021	Menaxhmenti/ Senati/ Zyra për projekte të sponsorizuar/ NJA	Shih: Plani i zhvillimi strategjike te Kolegje Dardania

Në kuadër të marrëveshjeve që do të realizohen në mes të institucioneve nga sektori publik dhe privat, studentëve të nivelit pasdiplomik (master) do t'u mundësohet që një pjesë të hulumtimeve të tyre ta kryejnë nëpër institucione nga sektori publik dhe privat. Kolegji Dardania, është i përkushtuar për ndërtimin e një sistem efektiv të menaxhimit të aktivitetave kërkimoroshkencore në rend të parë duke vendosur standarde të cilësisë në mësimdhënie e në kërkime shkencore duke i kushtuar rëndësi lidhjeve në mes të arsimit të lartë, kërkimeve shkencore, zhvillimit dhe mësimit gjatë gjithë jetës.

Kjo zyre do të merret me analizën e kapaciteteve, procedurave dhe Rregulloreve të brendshme që kanë ndikim në aktivitetet kërkimoroshkencore dhe është bartëse e aktivitetave rrëth përgatitjes së një plani të detajuar për kërkime shkencore përmes së cilit synohet edhe gjetja e fondeve për kërkime, planifikimi i shfrytëzimit të fondeve me efikasitet, dhe komercializimi i kapaciteteve infrastrukturore etj. Kjo zyre, në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të Kolegjit, do të kujdeset për zbatimin e vazhdueshëm të kritereve për sigurimin e cilësisë në kërkime shkencore duke përfshirë stimulime për stafin e suksesshëm. Përveç kësaj, zyrja do të mbaj kontakte të vazhdueshme me palët e interesit dhe do të asistoj njësitë dhe stafin e Kolegjit Dardania në hartimin e projekteve që përfshijnë ekonominë, dhe shoqërinë. Po ashtu, do të mbaj kontaktet me të diplomuarit të cilët janë të angazhuar nëpër kompani me qëllim të promovimit të inovacionit, transferit të teknologjisë dhe ndërmarrësisë. Në perspektivë, ky funksion i njësisë për mbështetje të kërkimeve shkencore do t'i bartet qendrës për inovacion dhe punësim. Kjo zyre do të zhvilloj dhe mirëmbaj bazën e të dhënave për aktivitete kërkimoroshkencore. Njësia për kërkime shkencore, në bashkëpunim me njësitë e Kolegjit, do të përgatisë planin vjetor për aktivitete kërkimoroshkencore duke identifikuar prioritetet dhe caqet në këtë fushë. Në këtë kuadër, edhe Grupi i Këshillëdhënës do të jep rekomandimet e tij për masat e nevojshme që duhet ndërmarrë për të përkrahur dhe ngritur nivelin e aktivitetave kërkimoroshkencore të Kolegjit.

Projektet e ardhshme në Kolegjin DARDANIA

Aktiviteti hulumtues i Kolegjit DARDANIA është i orientuar drejt dy temave thelbësore:

- 1. Rimëkëmbja e Biznesit të Vogël Covid-19 në Kosovë (në proces)** (Ky hulumtim do të bëhet nga Prof. Dr. Halim Gjergjizi and Prof. Msc. Bajram Gecaj, grup studentësh, dhe akademik Prof. Ass. Halim Gjergjizi si këshilltar i jashtëm dhe asistente administrative Valbona Elezi) 2021-2023.

Abstrakt: Për të eksploruar ndikimin e pandemisë COVID-19 në bizneset e vogla, ne zhvilluam një anketë në Fakultetin Ekonomik midis 28 marsit dhe 4 prillit 2020. U shfaqën disa tema, së pari, pushimet masive dhe mbylljet që kishin ndodhur tashmë - vetëm disa javë pas krizës; dhe së dyti, rreziku i mbylljes u shoqërua negativisht me kohëzgjatjen e pritshme të krizës. Për më tepër, bizneset kishin besime të ndryshme në lidhje me kohëzgjatjen e mundshme të ndërprerjeve të lidhura me COVID-19. Megjithatë, shumë probleme të parashikuara me aksesin në program, të tilla si telashet burokratike dhe vështirësitetë në vendosjen e përshtatshmërisë. Duke përdorur varpcionin eksperimental, ne vlerësojmë gjithashtu normat e pranimit dhe efektet e qëndrueshmërisë së biznesit për kreditë në lidhje me programet e bazuara në grante.

Objektivi: Përveç ndikimit të tij në shëndetin publik, pandemia COVID-19 ka shkaktuar një tronditje të madhe ekonomike. Në këtë punim, ne eksplorojmë ndikimin e COVID-19 në peizazhin e biznesit të vogël në Shtetet e Bashkuara, duke u fokusuar në tre pyetje. Së pari, si u përshtatën bizneset e vogla ndaj ndërprerjeve ekonomike që rezultojnë nga COVID-19? Së dyti, sa prisin bizneset të zgjaste kriza dhe si ndikojnë pritshmëritë në vendimet e tyre? Së treti, si mund të ndikojnë propozimet alternative të politikave në qëndrueshmërinë e biznesit dhe punësimit?

- 2. Diplomacia Kulturore - Mekanizëm i Stabilitetit në Kosovë** (Ky hulumtim do të zhvillohet nga PhD. Njomza Mehani; PhD. Njomza Krasniqi; Prof. Dr. Enver Hasani si këshilltar i jashtëm, Anesa Gashi studente dhe asistente administrative Elza Gashi). Hulumtimi do të realizohet në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Diplomaci Kulturore - KICD) 2021-2023

Abstrakt: Ky hulumtim është menduar si një vlerësim i ndikimit të përfshirjes së diplomacisë kulturore për përmirësimin e imazhit të Kosovës si dhe për të ndërtuar stabilizimin, besimin, promovimin e paqes dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet vendeve. Një instrument thelbësor për Kosovën në avancimin e objektivave dhe përmirësimin e profilit të saj ndërkontekstuar është diplomacia kulturore. Kosova duhet të angazhohet me audiencën globale, të përhapë mesazhin e saj dhe të avancojë interesat e saj përmes aktiviteteve kulturore dhe arsimore. Për më tepër, Kosova duhet të përqendrojë përpjekjet e saj të diplomacisë kulturore në nxitjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkontekstuar përmes nismave, aktiviteteve dhe ngjarjeve të shkëmbimit kulturor. Synimi në këtë hulumtim do të jetë të përpinqet të gjëjë pika të përbashkëta dhe të përpinqet t'i nxise ato përmes diplomacisë kulturore.

Objektivi: Për të studiuar këtë temë në mjedisin aktual, ky hulumtim do të fokusohet në politikën e jashtme të Kosovës. Kosova si vendi më i ri në Evropë, që synon integrimet evropiane, duhet të fokusohet më shumë në diplomacinë bashkëkohore me fokus të veçantë në zghidhjen e konfliktit etnik me Serbinë. Për më tepër, Kosova synon të fitojë më shumë njohje nga shtetet tjera që nuk e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës dhe po ashtu të përmirësoj imazhin e saj në arenë nombëtare.

Rezultatet: Bashkëpunimin kulturor përmes programeve të audiencës dhe shkëmbimeve kulturore, duke filluar nga rajoni dhe më gjerë ndihmon për t'i dhënë fund propagandës negative në Kosovë, për të përmirësuar imazhin në mbarë botën dhe për të krijuar një të ardhmeje më të mirë për gjeneratën e re në Kosovë.

3. **Përdorimi i sistemeve SCM dhe CRM për Ndërmarrjet e reja në Kosovë.** (Ky hulumtim do të bëhet nga PhD cand. Egzon Gashi, MA Visar Pacolli, grup studentësh të programit Administrim Biznes dhe Ekonomi, dhe akademik Izet Zeqiri si këshilltar i jashtëm dhe asistente administrative Valbona Elezi) 2019-2023.

Abstrakt: Hulumtimi ka për qëllim të vlerësojë përdorimin e Sistemeve të Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit (SCM) dhe Sistemeve të Menaxhimit të Marrëdhënieve me Konsumatorët (CRM) në Ndërmarrjet e reja në Kosovë. Sistemet SCM mund t'i ndihmojnë bizneset të menaxhojnë marrëdhëniet e tyre me furnitorët e tyre, të menaxhojnë inventarët (mbledhjen e stoqeve) dhe ofrimin e produkteve dhe shërbimeve

në një mënyrë më efikase. Ndërsa sistemet CRM ndihmojnë bizneset të mbajnë komunikim dhe marrëdhënie efektive me klientët e tyre. Ofrojnë informacion për të koordinuar të gjitha proceset e biznesit që kanë të bëjnë me shitjet, marketingun dhe shërbimin në mënyrë që të optimizojnë të ardhurat, kënaqësinë e klientit dhe të ruajnë numrin e klientëve. Qëllimi i këtij hulumtimi është të gjejë se cili sistem është i përballueshëm dhe më i dobishëm për ndërmarrjet e reja në Kosovë dhe a ka biznese që përdorin njërin nga këto sisteme.

Objektivat: Për të studiuar këtë çështje, hulumtimi do të fokusohet në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë, pasi është qyteti me rritjen më të shpejtë ekonomike, dhe si kryeqytet, është më tërheqës nga bizneset për të investuar. Cilat biznese e kanë më të përballueshme të investojnë në këto sisteme? A janë ndërmarrjet e reja të gatshme të investojnë në këto sisteme në fillimin e proceseve të tyre të biznesit? Bizneset në cilën industri e kanë më të përballueshme dhe a e vlerësojnë si të dobishme investimin e tyre në sisteme të tillë?

Rezultatet: Hulumtimi synon të komunikojë rezultatet e gjetura se sa biznese po përdorin këto sisteme dhe si e vlerësojnë përdorimin e tyre, si dhe sa prej tyre po marrin parasysh të investojnë në sisteme të tillë. Hulumtimi synon të specifikojë avantazhet e përdorimit të sistemeve SCM dhe CRM në trajtimin e çështjeve të ndryshme menaxheriale dhe sfidave të një ekonomie të tregut të lirë. Përveç përparësive, hulumtimi do të përfshijë vështirësi apo dobësi në aplikimin e sistemeve të tillë në Kosovë. Hulumtimi do të ofrojë rekomandime në lidhje me përdorimin e sistemeve SCM dhe CRM për bizneset në Kosovë.

4. Një model i ndryshimit organizativ. Teoria empilike e lidershipit (Një hulumtim që do të bëhet nga PhD. 2021 – 2022 (e përfunduar).

Abstrakt: Ky punim fokusohet gjithashtu në teorinë implicite të lidershipit. Teoritë e nënkuptuara të lidershipit shpesh lidhen me konceptin e suksesit. Ky punim, bazuar në literaturën ekzistuese, prezantoi një kornizë rreth koncepteve dhe teorive të nënkuptuara të lidershipit. Krahës kësaj, lidhja e koncepteve dhe teorive do të përputhet me situatën në Kosovë përmes shembujve teorikë, Kosova në rrugëtimin e saj shtetformues përballet me një rëndësi të madhe për ndryshim dhe zhvillim pothuajse në të gjitha fushat, dhe me theks të veçantë në politikë, ekonomike dhe sociale.

5. Orientimi në karrierë për nxënësit e shkollave të mesme në Kosovë (Një hulumtim që do të kryhet nga PhD. Can. Florentina Dushi; PhD Mariela Lazi, Prof. Dr. Besnik Spahiu si ekspert i jashtëm dhe Erisona Zuka si asistente administrative). 2021-2023.

Abstrakt: Studimi synon të identifikojë rrugët e karrierës së nxënësve të shkollave të mesme. Mostra do të përbëhet nga nxënësit e klasave 11 dhe 12 të shkollave të mesme të Prishtinës. Pjetja kryesore hulumtuese e këtij hulumtimi është identifikimi i masave të orientimit në karrierë që ndërmerren në Kosovë dhe ndikimi i aktorëve të ndryshëm në zgjedhjen e një programi studimi.

6. Stilet e lidershipit dhe instrumentet e burimeve njerëzore në sektorin joqeveritar në Kosovë (Hulumtim që do të kryhet nga PhD. Albulena Kadriu, PhD.Cand. Egzon Gashi, Prof.Dr. Avdullah Hoti si ekspert i jashtëm, studnetë, si dhe ssistente Administrative) 2021- 2023.

Abstrakt: Studimi synon të identifikojë mjetet e rekrutimit të BNJ që janë të përshtatshme për sektorin joqeveritar në Kosovë. Mostra do të përbëhet nga 100 OJQ në mbarë Kosovën, me një punonjës 10 – 50. Studimi do të rezultojë me listën e mjeteve përkatëse dhe rekomandime për hulumtime të mëtejshme.

7. Identifikimi i nevojave të fëmijëve të talentuar (Ky hulumtim që do të bëhet nga PhD Mimoza Shahini; PhD.Cand. Florentina Dushi; PhD Mariela Lazi, Studente: Anesa Gashi; Dr. Demë Hoti si eksperte e jashtëm, X. Y - si asistente administrative) 2023-2024.

Abstrakt: Studimi synon të identifikojë nevojat mësimore të fëmijëve të talentuar. Pjetja kryesore e hulumtimit është identifikimi i nevojave thelbësore të të mësuarit të fëmijëve të talentuar. Mostra do të përbëhet nga fëmijë të talentuar tashmë të identifikuar në Kosovë, të moshës 7-14 vjeç.

8. Aspektet ligjore të parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe riintegrimi i viktimave të trafikimit (Ky hulumtim do të zhvillohet nga PhD Selema Allamani Dushku; PhD Lon Laska dhe PhD Rezak Jakupi, studentët, si dhe X. Y si asistente administrative). 2021-2023.

Abstrakt - Trafikimi cenon të drejtat e njeriut duke kufizuar lirinë dhe duke rrezikuar jetën dhe sigurinë e individëve. E vendos personin në një gjendje skllavërie, shfrytëzimi dhe për pasojë e viktimizon atë. Ai kufizon aksesin e viktimateve në kujdesin shëndetësor ose shërbimet mjekësore, kushtet e duhura sanitare, arsimimin ose kontaktin me anëtarët e familjes. Shkelja e të drejtave të punës, gjatë shfrytëzimit në periudhën e trafikimit, përfshin mospagesën e pagës, shkeljen e masave të sigurisë dhe mosrespektimin e numrit maksimal të orëve. Për më tepër, krimet e kryera kundër një viktime gjatë procesit të trafikimit përfshijnë frikësimin, vjedhjen e pronës ose dokumenteve, kufizimin e paligjshëm të lirisë, sulmin e rëndë seksual, prostitucionin e detyruar, përdhunimin apo edhe vdekjen. Ajo ndërpërt zhvillimin e një jete 'normale' të viktimit duke e penguar atë të përfitojë ekonomikisht nga aftësitë e tij fizike dhe intelektuale.

Trafikimi ndikon në marrëdhëniet shoqërore, krijon një ndjenjë frike dhe pasigurie dhe zvogëlon besimin e ndërsjellë midis anëtarëve të shoqërisë, si dhe institucioneve të shteteve. Gjithashtu, ajo dëmton rëndë ekonominë duke u mundësuar individëve, shteteve dhe korporatave të maksimizojnë fitimet përmes shfrytëzimit të njerëzve.

Trafikimi kryhet nga aktorë të ndryshëm në nivele mikro, të mesme dhe makro. Ai mund të kryhet nga trafikantë individualë, korporata/biznese si dhe grupe/rrjete kriminale në nivel vendas dhe ndërkombëtar.

Ajo që nuk vlerësohet gjithmonë në mënyrën se si shtetet luajnë një rol të madh në trafikim, diçka që merr më pak se vëmendja që meriton nga ana e kërkimit përkatës të shkencave sociale. Kjo tezë synon të adresojë këtë mangësi në studimet e fundit dhe aktuale. Puna sociale ka ndërtuar identitetin e saj në adresimin e problemeve sociale. Ai synon gjenerimin e njohurive të reja për shkaqet, pasojat dhe zgjidhjet e mundshme të problemeve që prekin individët, grupet dhe shoqëritë në nivel lokal apo global. Puna sociale është e angazhuar në të drejta dhe drejtësi dhe ekziston për të ndihmuar, mbështetur ata që vuajnë nga efektet negative të pabarazive sociale. Në të njëjtën kohë, ai trajton dështimet, në fusha specifike, të politikave si krimi, shëndetësia dhe arsimi. Punonjësit socialë duhet të fokusohen në studimin e problemit të krimtit të trafikimit, pra në shqetësimet e perceptuara që nuk janë kriminalizuar, në vend të akteve kriminale që u referohen atyre veprimeve që tashmë janë të kriminalizuara në legjislacion.

Rezultatet - Ky studim do të kontribuojë në një kuptim më të mirë të trafikimit të qenieve njerëzore. Përkufizimi ligjor dhe si ndikon ai në procesin e luftimit dhe parandalimit të trafikimit si dhe në procesin e identifikimit të viktimateve të trafikimit. Një kuptim më i mirë i sfidave me të cilat përballet qeveria në luftën dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore

Të kuptuarit e procesit të identifikimit dhe riintegrimit të viktimateve të trafikimit.


Kuptimi i sfidave me të cilat përballet procesi i riintegrimit.

Një kuptim më i mirë i rolit të punonjësit social në luftimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe procesin e identifikimit dhe riintegrimit të viktimateve të tij.

Kontributi në kuptimin më të mirë të fenomeneve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e luftës kundër trafikimit dhe procesit të riintegrimit.

Fjalët kyçë: Punë sociale, Shteti, Trafikimi i Qenieve Njerëzore.

Resurset hapësinore-teknike




Research Hall 1



Research Hall 2



Videoconference Hall



Salla e Videokonferencës

Prishtinë, 2021.